



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:043113
Datë: 16.02.2024
Numri i dokumentit: 05342104

KPPP.nr. 1857/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit NLB Prishtina Sh.A. me seli në Prishtinë, kundër debitorit N.T.Sh. “Abis” me seli në Prishtinë me pronar A.I. nga fshati Dumnicë e Poshtme, Podujevë, me bazë juridike borxh sipas titullit ekzekutiv, jashtë seancës, me datë 15.02.2024 merr këtë:

KONKLUZION

- I. Lënda e identifikuar pranë kësaj gjykate me shenjën KPPP.nr. 1857/23 (lidhja E.nr. 17/05), në mes të kreditorit NLB Prishtina Sh.A. me seli në Prishtinë, kundër debitorit N.T.Sh. “Abis” me pronar A.I. nga Podujeva, i dorëzohet për procedim të mëtutjeshëm Përbaruesit Privat Driton Govori, me seli të zyrës në Prishtinë.
- II. Veprimet në procedurën e përbarimit të ndërmarra nga Gjykata janë të vlefshme ligjërisht sikurse të ishin ndërmarrë nga Përbaruesit Privat i cili vazhdon përbarimin.

A r s y e t i m

Në këtë çështje përbarimore, ish-Gjykata Ekonomike e Qarkut, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit NLB Prishtina Sh.A. me seli në Prishtinë, përmes aktvendimit E.nr. 17/05 të datës 08.02.2005 kishte lejuar përbarimin kundër debitorit N.T.Sh. “Abis” me seli në Prishtinë me pronar A.I. nga fshati Dumnicë e Poshtme, Podujevë, për realizimin e borxhit në bazë aktgjykimit IV.C.nr. 276/2003 të datës 08.01.2004 të lëshuar nga po kjo gjykatë në vlerë prej 51,129.00 EUR. Ndërsa, përmes aktvendimit E.nr. 17/2005 të datës 29.10.2012, gjykata e

lartcekur, duke vepruar si organ përmbarues, kishte ndërprerë procedurën në këtë çështje përmbarimore, kjo për faktin se debitori është shuar së ekzistuari.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale të Kosovës, lënda në fjalë është transferuar për në Gjykatën Komerciale të Kosovës për shqyrtim të mëtejme në bazë të kompetencës lëndore, dhe njëjta ka marrë numrin KPPP.nr. 1875/22.

Pala kreditore, përmes parashtrësës së datës 13.11.2023, ka kërkuar nga Gjykata Komerciale që lënda në fjalë të transferohet për procedim të mëtutjeshëm tek Përmbaruesi Privat Driton Govori.

Gjykata shqyrtoi kërkesën e kreditorit për transferim të lëndës tek Përmbaruesi Privat dhe meqenëse në rastin konkret nuk evidentohet ndonjë mjet juridik për të cilën kjo gjykatë është kompetente për vendosje sipas nenit 13, par.1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, në pajtim me nenin 397, par.3 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, me të cilën përcaktohet se *“Në çdo lëndë kur procedura përmbarimore nuk është përfunduar më 1 janar 2014, dhe në të cilën kreditori ka kërkuar që lënda të vazhdojë të procedohet nga përmbaruesi privat në pajtim me paragrafin 2. të këtij neni, Gjykata do të komplotoj të gjitha dokumentacionin lidhur me rastin e përmbarimit, specifikoj shpenzimet e ngarkuara nga Gjykata, dhe do të lëshoj konkluzion për dorëzimin e rastit tek përmbaruesi privat. Gjykata do ta përcjelle rastin tek përmbaruesi privat i zgjedhur nga Kreditori brenda (8) tetë ditëve pas marrjes së kërkesës së tillë”*, u veprua sipas këtij konkluzioni.

Nga të lartcekurat, e në pajtim me nenin 3 par.5 në lidhje me nenin 397 par.3 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin e këtij konkluzioni.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1857/23, datë 15.02.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa.